



HELVETAS

Pyetjet më të shpeshta lidhur me Auditimin Financiar





HELVETAS

Pyetje të shpeshta lidhur me Auditimin Financiar

**Shkaqet më të shpeshta dhe adresimi i
Opinioneve të Modifikuara të Auditimit në
komunat e Kosovës**

Prishtinë, korrik 2025

Ky dokument ofron një përmbledhje pyetjesh më të shpeshta dhe udhëzimeve për të ndihmuar komunat e Kosovës në përgatitjen për auditim, sigurimin e pajtueshmërisë financiare dhe adresimin e çështjeve të zakonshme të hasura gjatë procesit të auditimit. Qëllimi i tij është të ofroj njohuri për të gjithë, përfshirë stafin jo financiar, për të kuptuar terminologjinë e auditimit financiar dhe çështjet kryesore me të cilat përballen komunat e Kosovës në menaxhimin financiar.

Burimet kryesore: *Legjislacioni kombëtar i Kosovës, raportet e auditimit për komunat e Kosovës, të publikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit, SNISA-t - Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, të lëshuara nga INTOSAI, SNRF - Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.*

Ky publikim është bashkë-financuar nga Bashkimi Evropian, Zvicra dhe Suedia përmes projektit DEMOS, i zbatuar nga Helvetas Swiss Intercooperation.

Përmbajtja është përgjegjësi e vetme e autorit dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Helvetas Swiss Intercooperation, Bashkimit Evropian, Zvicrës apo Suedisë. Të lartëpërmendurit nuk marrin përgjegjësi për ndonjë gabim, mospërfshirje apo interpretim që mund të përmbahet në këtë botim.

© DEMOS Publikuar: Korrik 2025, Prishtinë, Kosovë

Përmbajtja

1	Përmbledhje e përgjithshme e auditimit financiar në Kosovë	5
2	Arsyet më të shpeshta për Opinion të Modifikuar të Auditimit në komunat e Kosovës - dhe si t'i rregullojmë ato	6
3	Rolet dhe përgjegjësitë për zbatimin e gjetjeve të auditimit.	14
4	Si duhet t'i zbatojnë komunat rekomandimet e auditimit	15
5	Ndikimi i mospajtueshmërisë me Standardet e Kontabilitetit Financiar	16
6	Auditimi financiar - Fjalorth termash	17

1 Përmbledhje e përgjithshme e auditimit financiar në Kosovë

Auditimi financiar i komunave të Kosovës përfshin disa institucione që punojnë së bashku për të siguruar transparencën, llogaridhënien dhe menaxhimin e duhur të fondeve publike. Zyra Kombëtare e Auditimit, departamentet e financave në komuna, auditorët e brendshëm, si dhe zyrtarët e zgjedhur kanë të gjithë një rol vendimtar në adresimin e gjetjeve të auditimit dhe përmirësimin e praktikave financiare komunale.

Çka është auditimi financiar? Auditimi financiar është vlerësimi i pavarur i pasqyrave financiare të një entiteti për të përcaktuar saktësinë, transparencën dhe përputhshmërinë e tyre me ligjet, rregulloret dhe standardet në fuqi. Ai ofron siguri se pozicioni financiar i raportuar, performanca dhe përdorimi i burimeve paraqiten në mënyrë të drejtë dhe në përputhje me kornizën përkatëse të raportimit financiar.

Pse është i rëndësishëm auditimi financiar për komunat? Auditimet financiare janë thelbësore për të siguruar që fondet publike menaxhohen në mënyrë të përshtatshme. Ato rrisin transparencën, nxisin llogaridhënien dhe mbështesin qeverisjen e mirë në përdorimin e burimeve komunale.

Cili është roli i Auditorit të Përgjithshëm dhe i Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA)? Auditori i Përgjithshëm, si kreu i ZKA-së, i jep llogari Kuvendit të Kosovës dhe vepron sipas autoritetit të Kushtetutës, legjislacionit kombëtar, akteve nënligjore dhe standardeve të njohura ndërkombëtare isht të auditimit të sektorit publik. ZKA-ja është institucion i pavarur përgjegjës për auditimin e pasqyrave financiare të komunave të Kosovës. Ajo identifikon dobësitë në menaxhimin financiar, ofron opinione të pavarura mbi raportet financiare dhe jep rekomandime për përmirësim për të forcuar transparencën dhe llogaridhënien e sektorit publik, përfshirë nivelin komunal.

Cili është ndryshimi midis auditimit të brendshëm dhe atij të jashtëm?

- **Auditimi i brendshëm** kryhet nga personeli brenda organizatës. Ai përqendrohet në vlerësimin dhe përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, menaxhimin e riskut dhe efikasitetin operacional.
- **Auditimi i jashtëm** kryhet nga një auditor i pavarur (siç është ZKA-ja) për të shprehur një opinion objektiv nëse pasqyrat financiare janë pa anomali materiale dhe të paraqitura në mënyrë të drejtë sipas kornizës përkatëse të raportimit financiar.

2 Arsyet më të shpeshta për Opinion të Modifikuar të Auditimit në komunat e Kosovës - dhe si t'i rregullojmë ato

Çështja 1: REGJISTRIMI JOADEKUAT I PASURIVE

Mangësitë në regjistrimin e pasurive kapitale dhe jokapitale

Çfarë nënkuptohet me regjistrimin joadekuat të pasurive?

Regjistrimi joadekuat i pasurive, siç kuptohet sipas Rregullores MF – Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare nga Organizatat Buxhetore, i referohet dështimit të një organizate buxhetore për të përmbushur plotësisht kërkesat për regjistrimin, klasifikimin dhe mbajtjen e të dhënave të sakta mbi pasuritë jofinanciare në regjistrat zyrtarë të pasurive. Kjo përfshin dështimet për të dokumentuar pasuritë, futjen e pasaktë ose jo të plotë të detajeve të pasurive, siç janë vlera, vendndodhja dhe pronësia, mungesën e përditësimeve në kohë pas blerjeve ose shitjeve (tjetërsimeve), dhe mospërputhjet midis pasurive fizike dhe informacionit të regjistruar.

Pse është ky një problem?

Regjistrimi joadekuat i pasurive është problem sepse dobëson raportimin financiar, rrit rrezikun e humbjes ose keqpërdorimit të pasurive dhe pengon planifikimin dhe kontrollin efektiv. Ai dëmton transparencën, llogaridhënien dhe menaxhimin e duhur të pasurive publike.

Si mund ta përmirësojnë komunat regjistrimin e pasurive?

Ja disa hapa kryesorë:

- Krijimi i një regjistri të plotë dhe të përditësuar të pasurive që përfshin të gjitha pasuritë jofinanciare me detaje të sakta (p.sh. vlera, vendndodhja, data e blerjes, gjendja, etj)
- Caktimi i numrave unikë të identifikimit ose barkodeve për çdo pasuri, për të mundësuar gjurmimin dhe verifikimin fizik.
- Sigurimi i klasifikimit të duhur të pasurive.
- Kryerja e inventarizimit të rregullt fizik dhe barazimi (rakordimi) i rezultateve me regjistrin e pasurive.
- Mbajtja e dokumentacionit të duhur për secilen pasuri, duke përfshirë kontratat, faturat dhe të dhënat e transferimit.
- Zbatimi i kontrolleve të brendshme dhe auditimeve periodike për të verifikuar saktësinë dhe plotësinë e të dhënave të pasurive.
- Vendosja e politikave të qarta të brendshme për menaxhimin e pasurive.

Procedurat për regjistrimin fillestar të pasurive

(Për organizatat që nuk i kanë identifikuar dhe regjistruar plotësisht ose pjesërisht pasuritë e tyre)

Në rastet kur një organizatë buxhetore nuk e ka kryer më parë identifikimin dhe regjistrimin e pasurive të saj, duhet të zbatohet procedura për regjistrimin fillestar të pasurive. Kjo procedurë përfshin hapat e mëposhtëm:

Themelimi i Komisionit për Identifikimin dhe Vlerësimin e pasurive

Organizata krijon një komision të përkohshëm me vendim të brendshëm për të identifikuar, verifikuar dhe vlerësuar të gjitha pasuritë ekzistuese të prekshme dhe të paprekshme.

Inventarizimi i plotë fizik

Komisioni kryen inspektimin fizik dhe dokumentimin e çdo pasurie, duke përfshirë:

- Vendndodhjen
- Përshkrimin teknik
- Gjendjen fizike
- Vlerën e përlogaritur (në mungesë të dokumentacionit mbështetës)

Përgatitja e listave të pasurive

Pas përfundimit të procesit të identifikimit, komisioni përgatit lista të detajuara sipas kategorive të pasurive (kapitale dhe jokapitale), të cilat më pas miratohen nga Udhëheqësi i Organizatës Buxhetore.

Përgatitja e dokumentacionit të regjistrimit

Në mungesë të dokumenteve origjinale (urdhër-blervjeve, faturave, etj.), komisioni harton një raport zyrtar vlerësimi për secilës pasuri, i cili shërben si bazë për regjistrim.

Regjistrimi në Sistemin e-Pasuria dhe, nëse është e aplikueshme, në SIMFK

Zyrtari i Pasurive regjistron të gjitha pasuritë në sistemin e-Pasuria dhe pasuritë me vlerën mbi 1,000 € regjistrohen gjithashtu në sistemin Free Balance (SIMFK), nëse është e aplikueshme.

Si të sigurohemi që të gjitha pasuritë e blera gjatë vitit fiskal regjistrohen në regjistrat e pasurive?

Për të siguruar një regjistrim të saktë të të gjitha pasurive të blera gjatë vitit fiskal, është thelbësore të kryhet një verifikim i plotë i regjistrit financiar (Free Balance) për të gjitha blerjet e bëra gjatë periudhës raportuese. Ky proces përfshin shqyrtimin e të gjitha shpenzimeve, pavarësisht nga kategoria e tyre: investime kapitale, mallra dhe shërbime, apo subvencione dhe transfere, për të identifikuar pagesat që lidhen me pasuritë dhe për të konfirmuar regjistrimin e tyre në regjistrat e pasurive.

1. Verifikimi i pagesave nga kategoria e Investimeve Kapitale

- Identifikoni të gjitha pagesat nga kategoria ekonomike e investimeve kapitale.
- Verifikoni që janë marrë dokumentet e duhura për të gjitha pagesat.
- Sigurohuni që pasuritë e blera të regjistrohen me saktësi në regjistrat e pasurive.

2. Verifikimi i pagesave nga kategoria e Mallrave dhe Shërbimeve

- Rishikoni të gjitha pagesat e bëra në kategorinë Mallra dhe Shërbime për të përcaktuar nëse ndonjëra prej tyre përfshin blerje të pasurive.
- Nëse ndonjë pagesë e tillë ka rezultuar në blerjen e pasurive, Zyrtari i Pasurive duhet të mbledhë dokumentacionin mbështetës të nevojshëm dhe të sigurojë që pasuria të regjistrohet saktë në regjistrin përkatës të pasurive.
- Përveç kësaj, Zyrtari i Pasurisë mund të rrisë saktësinë e regjistrit të pasurive duke krahasuar pagesat që lidhen me pronën komunale me pasuritë e regjistruara. Për shembull, shqyrtimi i pagesave për energji elektrike, ujë, shërbime të mbeturinave dhe faturave të tjera të shërbimeve komunale të tilla si shkollat, qendrat shëndetësore dhe ndërtesat komunale, dhe krahasimi i tyre me regjistrin e pasurive, mund të ndihmojë në identifikimin e pasurive të paregjistruara dhe në adresimin e çdo boshllëku ose pasaktësie në dokumentimin e pasurive.

3. Verifikimi i pagesave nga kategoria e Subvencioneve dhe Transfereve

- Identifikoni pagesat për të vlerësuar nëse ndonjëra prej tyre ka rezultuar në krijimin e pasurive.
- Nëse ndonjë pagesë e tillë ka rezultuar në blerjen e pasurive, Zyrtari i Pasurisë duhet të mbledhë dokumentacionin mbështetës të nevojshëm dhe të sigurojë që pasuria të regjistrohet saktë në regjistrin përkatës të pasurive.
- Verifikoni pagesat për t'u siguruar që subvencionet dhe grantet e dhëna palëve të treta nuk regjistrohen gabimisht si pasuri komunale.
- Verifikime shtesë që Zyrtari i Pasurisë mund t'i konsiderojë të nevojshme për të siguruar që të gjitha pasuritë komunale janë të regjistruara saktë përfshijnë: verifikimin e të dhënave të prokurimit me regjistrin e pasurive; shqyrtimin e dokumentacionit që lidhet me shitjet (tjetërsimet) e pasurive, transferimet, shpronësimet, donacionet e bëra nga komuna për organizata të tjera ose të marra nga komuna; dhe shkëmbimet e pronave bazuar në vendimet e kuvendit komunal. Procesi përfshin gjithashtu inspektimin e të dhënave të mirëmbajtjes dhe

sigurimit dhe koordinimin me departamentet përgjegjëse për menaxhimin e pasurive fizike. Këto veprime ndihmojnë në verifikimin e ekzistencës, gjendjes dhe klasifikimit të duhur të pasurive, duke kontribuar kështu në plotësinë dhe saktësinë e regjistrit të pasurive.

Ky proces verifikimi duhet të kryhet periodikisht gjatë gjithë vitit, dhe të paktën një herë në fund të vitit fiskal, për të siguruar që të gjitha pasuritë komunale janë regjistruar me saktësi. Përditësimet e rregullta rrisin transparencën dhe forcojnë menaxhimin e pasurive publike, duke siguruar prezantimin e tyre të saktë në pasqyrat financiare të komunës.

Pse ka rëndësi?

Regjistrimi i saktë i pasurive është thelbësor për një menaxhim të shëndoshë financiar publik.

Pasuritë komunale të regjistruara siç duhet mundësojnë planifikimin, buxhetimin dhe mirëmbajtjen e informuar të infrastrukturës publike. Ai siguron që burimet publike të mbrohen, zvogëlon rrezikun e keqpërdorimit ose humbjes së pasurive dhe mbështet vendimmarrjen e informuar.

Për më tepër, të dhënat transparente dhe të besueshme të pasurive rrisin llogaridhënien ndaj qytetarëve dhe institucioneve mbikëqyrëse, duke përforcuar besimin publik në qeverisjen lokale.

Nga ana tjetër, regjistrimi joadekuat dëmton këto qëllime dhe mund të çojë në joefikasitet, shpërdorim dhe madje edhe korrupsion.

Çështja 2: DETYRIMET KONTIGJENTE JO TË REGJISTRUARA SI DUHET

Shpalosja jo e plotë e detyrimeve kontigjente në pasqyrat financiare - nënvlerësimi ose mbivlerësimi i tyre

Çfarë janë detyrimet kontigjente?

Detyrimet kontigjente janë detyrime të mundshme financiare që lindin vetëm nëse ndodhin ngjarje të caktuara në të ardhmen — më së shpeshti, vendime gjyqësore.

Pse janë të rëndësishme për komunat?

Nëse nuk regjistrohen ose raportohen siç duhet, ato mund të çojnë në tejkalime të buxhetit, kualifikime të auditimit dhe ulje të transparencës financiare.

Burimet kryesore të detyrimeve të kontigjente në komuna:

- Padi të ngritura nga mësimdhënësit sipas Marrëveshjeve Kolektive të viteve 2017 & 2021, duke përfshirë pretendime për: kompensimin e shtesave ditore për shujtat, shpërblime jubilarë, pagesa për largim nga puna, paga vjetore bonus dhe përfitime të tjera që rrjedhin nga marrëveshje të tilla.
- Mosmarrëveshje të tjera ligjore (p.sh. në lidhje me pronën, burimet njerëzore, prokurimin, etj.)

Edhe pse të dyja marrëveshjet kolektive (për arsim dhe shëndetësi) u anuluan në vitin 2022, gjykatat ende vendosin në favor të paditësve (lidhur me veprimet ligjore të nisura para anulimit të këtyre kontratave), duke krijuar një ndikim të konsiderueshëm financiar për komunat.

Si të përmirësohet menaxhimi dhe raportimi:

- ➔ **Krijimi dhe mirëmbajtja e një Regjistri të Detyrimeve kontigjente:** Përfshihen të gjitha paditë në vazhdim dhe detyrimet e mundshme; përditësohet rregullisht.
- ➔ **Sigurimi i komunikimit të rregullt midis:** Zyrës Ligjore / Përfaqësuesit Ligjor, Departamentit të Financave, sektorëve përkatës (BNJ, Prokurimi, Arsimi, Shëndetësia).
- ➔ **Formalizimi i procesit të raportimit:** Zyra Ligjore informon Financat për rastet e reja => Financat njoftojnë Zyrën Ligjore për pagesat e bëra => Largohen rastet e zgjidhura nga regjistri.
- ➔ **Rishikime dhe kontrole të rregullta:** Krahasohen të dhënat e çështjeve ligjore me të dhënat e Avokaturës Shtetërore. Sigurohet përputhshmëri midis regjistrave dhe pasqyrave financiare (PFV).

Pse ka rëndësi?

Shpalosja e saktë dhe e duhur e detyrimeve kontigjente në pasqyrat financiare të komunës është thelbësore për transparencën, llogaridhënien dhe planifikimin financiar efektiv. Në komunat e Kosovës, ku burimet financiare janë shpesh të kufizuara dhe mbikëqyrja publike është e lartë, mosshpalosja e detyrimeve të mundshme në të ardhmen, si rastet gjyqësore në pritje, pretendimet e pazgjidhura pronësore ose mosmarrëveshjet kontraktuale, mund të keqparaqesin pozicionin e vërtetë financiar të komunës. Kjo mungesë e shpalosjes pengon vendimmarrjen e informuar dhe rrezikon kosto të papritura që mund të ndërprejnë ofrimin e shërbimeve dhe të dëmtojnë besimin publik. Shpalosja e qartë e detyrimeve kontigjente rrit mbikëqyrjen, promovon qeverisjen e përgjegjshme dhe mbështet stabilitetin fiskal afatgjatë.

Çështja 3: KLASIFIKIMI I GABUAR I SHPENZIMEVE (KEQKLASIFIKIMI)

Regjistrimi i gabuar i shpenzimeve në kategoritë ekonomike joadekuate

Çfarë është klasifikimi i gabuar i shpenzimeve?

Kjo ndodh kur shpenzimet regjistrohen sipas kodeve ekonomike joadekuate, në buxhet ose raportet financiare — për shembull, pagesa e një detyrimi ligjor nga kategoria e gabuar (p.sh. mallra dhe shërbime në vend të pagave ose investimeve kapitale). Ky klasifikim i gabuar mund të përfshijë caktimin e kostove në linja të papërshtatshme buxhetore, si kategorizimi i shpenzimeve kapitale si shpenzime operative ose etiketimi i gabuar i pagesave që lidhen me pagat ose shërbimet komunale.

Pse është kjo problem për komunat?

- Çon në raportim financiar të pasaktë
- Ndërlikon planifikimin e buxhetit për vitet e ardhshme
- Pengon monitorimin e buxhetit
- Pengon pagesat në kohë, veçanërisht për detyrimet e urdhëruara nga gjykata.

Çfarë e shkakton klasifikimin e gabuar?

- Planifikimi jo i saktë i buxhetit
- Pagesat e bëra nga kode joadekuate (në vitet e fundit, kryesisht të shkaktuara nga pagesat e bëra nga Thesari për ekzekutimin e pagesave për vendimet gjyqësore dhe procedurat përmbarimore që lidhen me paditë që rrjedhin nga marrëveshjet kolektive)
- Mungesa e komunikimit midis departamenteve ligjore, financiare dhe departamenteve të tjera
- Vonesa në transferimet ose rialokimet e fondeve

Si mund ta parandalojnë ose zvogëlojnë komunat klasifikimin e gabuar?

- ➔ **Planifikimi me kujdes i buxhetit:** Përputhni detyrimet (p.sh., nga çështjet gjyqësore ose kontratat) me kodet e duhura që nga fillimi.
- ➔ **Zgjedhja e kohës së duhur për transferimin e fondeve:** Kur është e nevojshme, propozoni rialokim të fondeve në Kuvendin Komunal bazuar në një analizë të plotë financiare.
- ➔ **Përmirësimi i komunikimit ndërdepartamental:** Të mbahet komunikim i vazhdueshëm midis: Zyrës Ligjore, Departamentit të Financave dhe Thesarit dhe të inkurajohet bashkëpunimi midis departamenteve të tjera (Financa, Burimet Njerëzore, Prokurimi, Arsimi) për të kuptuar plotësisht të gjitha shpenzimet dhe klasifikimin e tyre të saktë dhe kohën e parashikuar të pagesës dhe detyrimet ligjore.

- **Kryerja e rishikimeve të rregullta të performancës së buxhetit:** Ndiqni devijimet dhe problemet gjatë vitit për të lejuar veprime korrigjuese në kohë.
- **Trajnimi i stafit rregullisht:** Ofroni trajnime periodike për stafin e financave dhe administratës mbi procedurat e buxhetimit, klasifikimit dhe raportimit.

Pse ka rëndësi?

Klasifikimi i saktë siguron: Pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret; Pasqyra financiare të qarta dhe të sakta; Kontroll të brendshëm dhe llogaridhënie më të fortë.

Çështja 4: PREZENTIMI JOADEKUAT I TË ARKËTUESHMEVE NË PASQYRAT FINANCIARE

Mbivlerësimi/nënvlerësimi i të arkëtueshmeve nga tatimet dhe burime të tjera

Çfarë janë llogaritë e arkëtueshme në komuna?

Llogaritë e arkëtueshme në komuna i referohen të ardhurave të faturuara, por të pambledhura, të cilat detyrohen nga individët, bizneset ose institucionet, duke përfshirë ato nga tatimi në pronë, aktivitetet e biznesit dhe burime të tjera të të ardhurave komunale. Regjistrimi dhe shpalosja e saktë e këtyre të arkëtueshmeve në Pasqyrat Financiare Vjetore (PFV) janë thelbësore për raportim të besueshëm financiar, mbledhje efikase të të ardhurave dhe buxhetim efektiv komunal.

Pse është ky një problem?

Shumë komuna përballen me sfida në raportimin e të arkëtueshmeve për shkak të:

- Të dhënave jo të plota ose të vjetruara
- Kontrolleve të brendshme të dobëta
- Koordinimit të dobët midis departamentit të financave dhe departamenteve që mbledhin të hyra komunale
- Mungesës së rishikimit të vazhdueshëm dhe pajtueshmërisë ligjore
- Mungesës së efikasitetit në mbledhjen e detyrueshme të të hyrave

Çfarë duhet bërë?

- **Mbajtja e një Regjistri të plotë dhe të përditësuar të të Arkëtueshmeve:** Të gjitha të hyrat e faturuara, por të papaguara, duhet të dokumentohen, të përditësohen rregullisht dhe të pasqyrohen në PFV në kategorinë e saktë.

- **Forcimi i kontrolleve të brendshme:** Sigurohuni që të gjitha dokumentet mbështetëse (faturat, kontratat, vendimet tatimore) të verifikohen dhe të përputhen me shifrat në regjistrin e të arkëtueshmeve dhe në PFV.
- **Përmirësimi i koordinimit midis stafit kryesor:** Drejtori Financiar (ZKF) dhe Zyrtarët e të Hyrave duhet të punojnë ngushtë për të:
 - Rishikuar rregullisht bilancet e papaguara (veçanërisht nga tatimi në pronë)
 - Analizuar dokumentet ligjore dhe financiare
 - Klasifikuar dhe vjetërsuar siç duhet të arkëtueshmet
 - Parandaluar mbivlerësimin e mbledhjeve (arkëtimeve) të pritura
- **Sigurimi i përcjelljes së duhur të mbledhjeve (arkëtimeve):** Procedura të përshtatshme për monitorimin dhe mbledhjen e shumave të prapambetura.
- **Kryerja e analizave të vjetërimit të llogarive të arkëtueshme:** Kategorizoni të arkëtueshmet bazuar në atë se sa gjatë kanë qenë të papaguara dhe vlerësoni gjasat e mbledhjes së tyre. Rregulloni pasqyrat financiare vjetore (PFV) përshtatshmërisht.
- **Zbatimi i përditësimeve në kohë reale ose periodike:** Përditësoni të arkëtueshmet për faturime, arkëtime ose shlyerje të reja sapo të ndodhin. Harmonizoni rregullisht të dhënat me evidencat e pagesave.
- **Sigurimi i pajtueshmërisë ligjore:** Verifikoni që të arkëtueshmet menaxhohen në përputhje me ligjet në fuqi dhe rregulloret lokale mbi tatimet, tariffat dhe të ardhurat.

Pse ka rëndësi?

Raportimi i saktë i të arkëtueshmeve: Rrit transparencën financiare; Siguron gatishmërinë për auditim; Ndihmon në menaxhimin efikas të mbledhjes së të ardhurave; Harmonizohet me standardet ligjore dhe të kontabilitetit.

3 Rolet dhe përgjegjësitë për zbatimin e gjetjeve të auditimit

Kush është përgjegjës për zbatimin e gjetjeve të auditimit? Përgjegjësia për zbatimin e gjetjeve të auditimit bie kryesisht mbi udhëheqjen komunale, duke përfshirë Kryetarin e Komunës, Drejtorin e Financave, Zyrтарin Kryesor Financiar, departamentet komunale të financave dhe stafin tjetër përkatës. Këta aktorë pritët të zbatojnë masa korrigjuese në përgjigje të rekomandimeve të auditimit. Auditorët e jashtëm, duke përfshirë Zyrën Kombëtare të Auditimit (ZKA), e mbështesin këtë proces duke ofruar vlerësime të pavarura dhe përcjelljen e zbatimit të rekomandimeve për të monitoruar progresin.

Çfarë roli luajnë Kuvendet Komunale në auditimin financiar? Kuvendet Komunale kanë një rol mbikëqyrës. Ato janë përgjegjëse për shqyrtimin e raporteve të auditimit, kërkimin e llogaridhënies nga udhëheqja ekzekutive dhe sigurimin që masat e rekomanduara të zbatohen për të përmirësuar qeverisjen financiare. Raporti i Auditimit dhe Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditimit diskutohen në një seancë të posaçme të Kuvendit Komunal.

Si e përcjell zbatimin e rekomandimeve Zyra Kombëtare e Auditimit? ZKA monitoron nëse komunat i kanë adresuar çështjet e ngritura në raportet e auditimit përmes përcjelljes së zbatimit të rekomandimeve dhe raportimit vjetor. Ajo mund të nxjerrë në pah dobësitë e përsëritura ose mungesën e progresit dhe mund të rekomandojë veprime të mëtejshme.

A mund të penalizohen komunat për mosveprim sipas rekomandimeve të auditimit?

Ndonëse ZKA-ja nuk shqipton ndëshkime drejtpërdrejt, mosveprimi sipas rekomandimeve të auditimit mund të çojë në dëmtim të reputacionit, rritje të mbikëqyrjes ose ndërhyrje nga nivele më të larta të qeverisë. Mund të ndikojë gjithashtu në financimin ose miratimin e projekteve nga donatorë ose institucione të jashtme. Për çështjet që lidhen me pajtueshmërinë, me mosrespektimin e kuadrit ligjor, gjetjet e auditimit mund të shërbejnë si burim informacioni për fillimin e procedurave hetimore nga autoritetet e zbatimit të ligjit.

Cili është roli i njësive të auditimit të brendshëm brenda komunave? Njësitë e auditimit të brendshëm ndihmojnë në sigurimin që kontrollet e brendshme funksionojnë në mënyrë efektive dhe që rreziqet menaxhohen siç duhet. Ato gjithashtu mbështesin menaxhmentin në përgatitjen për auditime të jashtme dhe në adresimin proaktiv të gjetjeve të auditimit.

4 Si duhet t'i zbatojnë komunat rekomandimet e auditimit

Komunat duhet të ndjekin një qasje të strukturuar dhe proaktive për zbatimin e rekomandimeve të auditimit. Kjo përfshin hapat kryesorë të mëposhtëm:

Zhvillimi i një plani veprimi të detajuar

Pas marrjes së raportit të auditimit, komuna duhet të përgatisë një Plan veprimi me afate të caktuara kohore dhe që përcakton qartë se si do të adresohet secili rekomandim i auditimit. Çdo veprim duhet të ketë një person ose departament përgjegjës të caktuar, siç parashikohet në shabllonin e ZKA-së.

Prioritizimi dhe alokimi i burimeve

Zbatimi i suksesshëm shpesh kërkon burime financiare, njerëzore dhe teknike. Udhëheqësit komunalë duhet të sigurohen që të alokohen burime të mjaftueshme për të zbatuar masat korrigjuese të identifikuara në auditim.

Sigurimi i trajnimit të stafit dhe ndërtimi i kapaciteteve

Në disa raste, gjetjet e auditimit rrjedhin nga mungesa e njohurive ose kapaciteteve. Stafi komunal, veçanërisht ata në financa, prokurim dhe menaxhimin e pasurive, duhet të marrin trajnime specifike për të forcuar kuptimin e procedurave financiare dhe kërkesave të pajtueshmërisë.

Ngritja e një mekanizmi monitorimi dhe raportimi

Monitorimi i rregullt është thelbësor. Komunat duhet të përcjellin progresin në zbatimin e rekomandimeve dhe ta raportojnë këtë përbrenda dhe te organet mbikëqyrëse siç është Kuvendi Komunal. Përditësimet e rregullta (p.sh. raportet tremujore të progresit) ndihmojnë në ruajtjen e momentumit dhe sigurojnë llogaridhënien.

Bashkëpunimi me auditorët e brendshëm dhe të jashtëm

Njësitë e auditimit të brendshëm mund të mbështesin zbatimin duke vlerësuar progresin dhe duke këshilluar mbi menaxhimin e riskut. Auditorët e jashtëm, përfshirë ZKA-në, mund të ofrojnë udhëzime dhe të kryejnë përcjelljen e zbatimit të rekomandimeve për të vlerësuar nëse çështjet janë adresuar në mënyrë të përshtatshme.

Kultivimi i një kulture llogaridhënieje dhe transparence

Përmirësimi afatgjatë varet nga ndërtimi i një kulture ku nëpunësit publikë e kuptojnë vlerën e menaxhimit të shëndoshë financiar dhe pasojat e mosveprimit. Udhëheqja komunale duhet të shërbejë si shembull duke i marrë seriozisht rekomandimet e auditimit dhe duke promovuar praktikën etike.

5 Ndikimi i mospajtueshmërisë me Standardet e Kontabilitetit Financiar

Cilat janë pasojat e mospajtueshmërisë me Standardet e Kontabilitetit Financiar?

Mospajtueshmëria me Standardet e Kontabilitetit Financiar mund të çojë në:

- Opinione auditimi të kualifikuara, të kundërta ose mohim të opinionit
- Moskualifikueshmëri për Grantin e Performancës Komunale
- Penalitete ligjore ose financiare
- Humbje të besimit publik
- Qasje të reduktuar në financimin nga donatorët ose mbështetjen e projekteve

Çfarë do të thotë një opinion i kualifikuar i auditimit për një komunë?

Një opinion i kualifikuar sinjalizon se disa pjesë të pasqyrave financiare nuk janë në përputhje me standardet ose kanë anomali materiale. Pasojat përfshijnë:

- Përfshirja nga Granti i Performancës Komunale
- Një kontroll më i madh nga organet mbikëqyrëse dhe publiku
- Dëmtim i reputacionit dhe besueshmërisë së komunës

6 Auditimi financiar

Fjalorth termash

Auditimi	do të thotë një ekzaminim i kualifikuar i pajtueshmërisë ose performancës ligjore dhe financiare, i kryer për të plotësuar kërkesat e menaxhmentit (auditimi i brendshëm), ose një subjekti të auditimit të jashtëm, ose çdo auditori tjetër të pavarur, për të përmbushur detyrimet statutores (auditimi i jashtëm).
Auditor	personi ose personat që kryejnë auditimin. Në kontekstin e Kosovës – auditori është një zyrtar i autorizuar nga Auditori i Përgjithshëm për të kryer të gjitha funksionet sipas Ligjit për Auditorin e Përgjithshëm;
Auditori i Përgjithshëm	kreu i Institucionit Suprem të Auditimit, i emëruar nga Kuvendi i Kosovës me propozimin e Presidentit të Republikës së Kosovës.
Entiteti i Audituar	çdo institucion publik, ndërmarrje publike ose autoritet tjetër që menaxhon fonde publike që i nënshtrohet auditimit.
Gjetjet e Auditimit	çështjet e identifikuara gjatë një auditimi, duke përfshirë fushat ku komuna nuk ka arritur të përmbushë kërkesat ligjore ose ku nevojiten përmirësime në menaxhimin financiar. Gjetjet e auditimit zakonisht detajohen në raportin e auditimit.
Opinion i Auditimit	do të thotë një shprehje zyrtare me shkrim e një opinion mbi pasqyrat financiare ose ndonjë proces të caktuar brenda një kuadri të specifikuar, që tregon konkludimin e përgjithshëm të auditorit bazuar në provat e auditimit të marra që ofrojnë një nivel të arsyeshëm sigurie (siguri të lartë, por jo absolute);
Raporti Financiar Vjetor	një raport i përgatitur nga komuna në fund të vitit fiskal, që përmbledh pozicionin e saj financiar, performancën dhe rrjedhen e parave të gatshme. RFV i nënshtrohet auditimit dhe ndihmon në vlerësimin e shëndetit financiar dhe qeverisjes të komunës.
Regjistri i Pasurive	një regjistër i detajuar i të gjitha pasurive në pronësi të komunës, duke përfshirë tokën, ndërtesat, infrastrukturën dhe pajisjet. Regjistri i pasurive ndihmon në sigurimin që pasuritë të kontabilizohen saktë dhe të menaxhohen siç duhet.
Auditimi i pajtueshmërisë	Auditimi i pajtueshmërisë trajton shkallën në të cilën entiteti i audituar ndjek rregullat, ligjet dhe rregulloret, politikat, kodet e përcaktuara ose kushtet e dakordësuara etj. Auditimi i pajtueshmërisë mund të mbulojë një spektër të gjerë çështjesh.

Kriteret	pikë referimet e përdorura për të vlerësuar një çështje, duke përfshirë, kur është relevante, pikat e referimit për prezantimin dhe shpalosjen. Kriteret mund të jenë formale ose më pak formale. Mund të ketë kritere të ndryshme për të njëjtën çështje.
Theksimi i Çështjes	një paragraf i veçantë në raportin e auditimit për të tërhequr vëmendjen e lexuesit mbi një çështje të rëndësishme të paraqitur ose të shpalosur në mënyrë të përshtatshme në pasqyrat financiare që, sipas gjykimit të auditorit, por që është aq e rëndësishme saqë duhet theksuar posaçërisht.
Auditimi Financiar	një vlerësim i pavarur, që rezulton në një opinion sigurie të arsyeshme, nëse gjendja financiare e raportuar e një entiteti, rezultatet dhe përdorimi i burimeve paraqiten në mënyrë të drejtë në përputhje me kornizën e raportimit financiar.
Pasqyrat Financiare	një përfaqësim i strukturuar i informacionit financiar historik, duke përfshirë shënimet përkatëse, që synon të komunikojë burimet ose detyrimet ekonomike të një entiteti në një moment në kohë ose ndryshimet e tyre për një periudhë kohore në përputhje me një kornizë raportimi financiar. Shënimet përkatëse zakonisht përmbajnë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.
Funksioni i Auditimit të Brendshëm	një aktivitet vlerësimi i krijuar ose i ofruar si shërbim për entitetin. Funksionet e tij përfshijnë, ndër të tjera, shqyrtimin, vlerësimin dhe monitorimin e adekuatshmërisë dhe efektivitetit të kontrollit të brendshëm.
Auditorët e Brendshëm	individët që kryejnë aktivitetet e funksionit të auditimit të brendshëm. Auditorët e brendshëm mund t'i përkasin një departamenti të auditimit të brendshëm ose një funksioni ekuivalent.
Kontrolli i Brendshëm	I gjithë sistemi i kontrolleve financiare dhe të tjera, duke përfshirë strukturën organizative, metodat, procedurat dhe auditimin e brendshëm, të vendosur nga menaxhmenti brenda qëllimeve të tij korporative, për të ndihmuar në zhvillimin e aktiviteteve të entitetit të audituar në një mënyrë të rregullt ekonomike, efikase dhe efektive; duke siguruar respektimin e politikave të menaxhmentit; duke ruajtur pasuritë dhe burimet; duke siguruar saktësinë dhe plotësinë e të dhënave kontabël; dhe duke prodhuar informacion financiar dhe menaxherial në kohë dhe të besueshëm.
SNISA	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, të lëshuara nga INTOSAI. SNISA-t janë standardet ndërkombëtare autoritative për auditimin e sektorit publik.
INTOSAI	do të thotë Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit.

Keqdeklarim	një ndryshim midis shumës, klasifikimit, prezantimit ose shpalosjes së një zëri të raportuar të pasqyrave financiare dhe shumës, klasifikimit, prezantimit ose shpalosjes që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën përkatëse të raportimit financiar. Keqdeklarimet mund të lindin nga gabimi ose mashtrimi.
Keqdeklarim Material	një gabim ose lëshim i rëndësishëm në pasqyrat financiare që mund të ndikojë në vendimmarrjen e përdoruesve të këtyre pasqyrave. Kjo mund të lidhet me njohjen, matjen ose shpalosjen e pasurive, detyrimeve, të ardhurave ose shpenzimeve.
Opinion i Modifikuar	një opinion i kualifikuar, një opinion i kundërt ose një mohim i opinionit. Institucioni Suprem i Auditimit organi publik i një shteti i cili, pavarësisht se si është emërtuar, konstituuar ose organizuar, në bazë të ligjit ushtron funksionin më të lartë të auditimit publik të atij shteti.
Opinion i Pamodifikuar	opinion i shprehur nga auditori kur ai arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën përkatëse të raportimit financiar.



**Co-funded by
the European Union**



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC**



**Sweden
Sverige**